



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN / MUNICIPALITY OF LIPJAN



Drejtoria i Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Datë/Datum/ Date:	10.03.2026
Për/Za/For:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës z. Avni Jashari - Shef i Kabinetit të Kryetarit
Nga/Od/From	z. Rexhep Rexhepi - Drejtori i Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari
Lënda/Subjecat/Subject:	Raporti për muajin Shkurt

I nderuar Kryetar z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit të Bujqësisë për periudhën nga 01.02.2026 deri me 28.02.2026

Lipjan 2026

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

SEKTORI I BUJQËSIË

Gjatë kësaj periudhe, Drejtorati i Bujqësisë ka zhvilluar një sërë aktiviteteve dhe takimesh pune me qëllim të planifikimit dhe realizimit të projekteve të parapara për vitin 2026. Në kuadër të këtyre aktiviteteve janë mbajtur takime të rregullta të stafit, ku janë diskutuar projektet që janë në fazën e përgatitjes dhe që synohet të implementohen gjatë këtij viti. Në këto takime është analizuar gjendja aktuale në sektorin e bujqësisë dhe janë shqyrtuar mundësitë për mbështetje të fermerëve përmes projekteve të ndryshme zhvillimore.

Gjithashtu, gjatë këtij muaji janë zhvilluar takime me organizata të huaja që veprojnë në sektorin e bujqësisë, me qëllim të bashkëpunimit në realizimin e projekteve të përbashkëta në kultura të ndryshme bujqësore. Në këto takime janë diskutuar mundësitë e mbështetjes për fermerët lokalë dhe zhvillimin e sektorëve të ndryshëm të prodhimit bujqësor. Pritet që gjatë muajve në vijim të konkretizohen dhe të përcaktohen projektet që do të implementohen në bashkëpunim me këto organizata.

Në kuadër të mbështetjes së fermerëve me mekanizëm bujqësor, Drejtorati ka filluar procedurat e prokurimit publik për furnizimin me mekanizëm bujqësor, konkretisht për blerjen e frezave të dheut për traktor dhe spërkatëseve, të cilat do të ndihmojnë në rritjen e efikasitetit dhe lehtësimin e punëve bujqësore për fermerët tanë.

Programi për subvencionimin e qumështit thirrje kjo e hapur nga Ministria e Bujqësisë, Drejtorati ka pranuar dokumentacionin për aplikim nga fermerët blegtorë për përfitimin e pagesave bazuar në cilësinë dhe sasinë e qumështit. Dokumentacioni i pranuar është duke u sistemuar dhe do të përcillet në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për shqyrtim të mëtejshëm dhe për realizimin e pagesave përkatëse për fermerët përfitues.

Në kuadër të reagimit ndaj dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, në Drejtoratin e Bujqësisë është formuar një Komision për vlerësimin e dëmeve, i cili ka për detyrë evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në sektorin bujqësor.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar edhe dalje në terren sipas kërkesave të qytetarëve lidhur me trajtimin e qenve endacakë. Në këtë drejtim janë zhvilluar diskutime dhe takime me aktivistë dhe organizata të ndryshme, me qëllim të hartimit dhe realizimit të një projekti për menaxhimin dhe trajtimin e qenve endacakë, për të cilin pritet bashkëpunim një bashkëpunim në muajt në vazhdimë.

Komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve ka pranuar gjithsej 68 lëndë në Drejtoratin e Bujqësisë, për të cilat është bërë vlerësimi në terren dhe janë plotësuar dokumentacionët . Pas përfundimit të procedurave administrative, këto lëndë do të procedohen për shqyrtim të mëtejme në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave (AME).